

Njoftim aplikimi për bursë financiare, përjashtim nga tarifa e shkollimit

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Mbështetur në VKM nr. 903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit,” i ndryshuar, VBA nr. 50 datë 15.10.2019 “Për procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për përfitim burse dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2019-2020, për studentët e shkëlqyer dhe studentët në nevojë”

NJOFTON:

Të gjithë studentët e regjistruar në programet e **Ciklit të parë të studimeve**, që plotësojnë kriteret për të përfituar:

A. BURSË FINANCIARE DHE PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT

1. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike.
2. Student që vjen nga shtresa sociale: Bashkëshortët, të cilët kanë fëmijë dhe janë të dy studentë.
3. Student që vjen nga shtresa sociale: Student, person me aftësi të kufizuara.
4. Student që vjen nga shtresa sociale: Student, i cili i ka të dy prindërit me aftësi të kufizuara
5. Student që vjen nga shtresa sociale: Student, me prind bashkëjetues pensionist dhe prindi tjetër i është ndarë nga jeta.
6. Student që vjen nga shtresa sociale: Student, i cili i ka të dy prindërit pensionistë.
7. Student që vjen nga shtresa sociale: Student, i cili është i treti e lart në radhën e fëmijëve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë.
8. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç.
9. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç.
10. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët që janë identifikuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore deri në moshën 25 vjeç.
11. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

B. VETËM PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT

12. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët romë dhe egjiptianë.
13. Student që vjen nga shtresa sociale: Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.

Studentët të dorëzojnë:

- Dokumentacionin provues të kriterit përkatës në formatin “KËRKESË PËR PËRFITIM BURSE DHE/OSE PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020”
- FORMULAR DEKLARIMI

Kërkesa dhe formulari i deklaramit gjendet në Web – site: www.uniel.edu.al rubrika Informacione / njoftime dhe të shkarkohet nga kjo adresë.

Dokumentacioni i përgatitur dhe i renditur sipas formularit të Aplikimit të dorëzohet nga vetë studenti në Protokoll - Zyra e e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni kati II Korpusi kryesor duke filluar nga data **15.10.2019 e në vijim**

V.O Studentët që paraqesin kërkesat nga data 15.10.2019 deri 31.10.2019 dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara, do të përfitojnë bursë financiare nga data e fillimit të vitit akademik 2019-2020 (data 14.10.2019).

Kërkesat e studentëve të dorëzuara pas datës 31 tetor 2019, do të përfitojnë bursë financiare në muajin pasardhës nga data e dorëzimit të dokumentacionit, sipas përcaktimeve në VKM-t përkatëse.